

KONTRATE-THEMELIMI

E

LIDHUR NDERMJET ORTAKEVE



1.Z. ARDJAN HAXHIHYSENI, i biri i Hajdarit, dtl. 24. 11. 1960, banues ne Durres, L. 17, Rr. "Deshmoret", Nr. 976,

2. Znj. ALBA DAJLANI, e bija e Bujarit, dtlindja 28. 12. 1967, banuese ne Durres, L. 13, Rr. "Tre Vellezerit Thanasi", Plepa – Durres.

te cilet vullnetarisht rane dakort si me poshte:

Neni 1

Te krijoje shoqerine me perjegjesi te kufizuar me emrin: "FASAL" SHPK me seli ne Durres, me adresë: Lagja Nr.14, Rruga "Bajram Tusha", Shkozet- Durres...

Neni 2

Shoqeria "FASAL" SHPK eshte person juridik shqiptar dhe vepron si e tille, qe nga dita e regjistrimit ne Gjykaten Tregtare (Rrethit) Tirane dhe qe nga momenti i paisjes me leje nga organet tatumore.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas neneve te kesaj kontrate Statutit bashkangjitur dhe legjislacionit shqiptar ne perjithesi

Neni 3

Veprimtaria e shoqerise "FASAL" SHPK eshte caktuar per nje periudhe kohe te papercaktuar ...

Neni 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise

Shoqeria "FASAL" SHPK ka si objekt te veprimtarise se saj: Prodhimi, montimi i ashensoreve dhe paisjeve elektrike ...

Neni 5
Kapitali themeltar


Kapitali themeltar i shoqerise "FASAL" SHPK perbehet vetem nga kontributet ne para qe eshte 100.000 (njeqindmije) lek..

- Ky kapital eshte i ndare ne 100 (njeqind) pjese, sejcila me vlore nominative 1.000 (Njemije) leke.
- Kontributet e ortakeve ne kapitalin themeltar te shoqerise dhe numri i pjesave nominative qe zoteron sejcili prej tyre jane si me poshte:

1.	ARDJAN HAXHIHYSENI	50.000 (PESEDHJETEMIJE) lek = 50 (PESEDHJETE) pjese nominative te kapitalit themeltar.
2.	ALBA DAJLANI	50.000 (PESEDHJETEMIJE) lek = 50 (PESEDHJETE) pjese nominative te kapitalit themeltar.

* Kuotat ne % te ortakeve ne kapitalin themeltar te shoqerise jane si me poshte:


1.	ARDJAN HAXHIHYSENI	50 (PESEDHJETE) %
2.	ALBA DAJLANI	50 (PESEDHJETE) %

* Derdhja e kapitalit themeltar ne shumat e parashikuara me siper eshte bere prane Deges se Bankes Tregetare Kombetare Durrës

Neni 6

Ne librin e shoqerise krijohet fondi themeltar i shoqerise, ku regjistrohen kapitalet (kontributet) e derdhura nga sejcili ortak. Ortaket nuk kufizohet ne rritjen e kontributit te tyre me fitimet qe rrjedhin nga veprimitaria e shoqerise. Menyra e rritjes se kapitalit themeltar, percaktohet ne menyre te detajuar ne Statutin bashkangjitur kesaj kontrate.

Neni 7



Shoqeria ka te drejte te kete llogari ne leke dhe ne valute, ne bankat shqiptare qe ne ato te huaja, ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ka te drejte te disponoje lirshem mjetet monetare te grumbulluara ne to...

Neni 8

- Fitimi i realizuar nga shoqeria, pasi shlyhen detyrimet ndaj te treteve, pasi zbriten fondet e detyruara dhe pasi likuidohen taksat ne masen e percaktuar nga legjislacioni shqiptar, pra fitimi neto i realizuar, ndahet ndermjet ortakeve ne menyre te barabarte.
- Humbjet qe mund te rezultojne gjate aktivitetit ekonomik te shoqerise, do te perballohen nga ortaket ne menyre te barabarte.
- Fitimi i realizuar nga ortaket ne kuadrin e kesaj shoqerie mund te transferohet lirshem jashte shtetit, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 9

- Ortaket dhe administratoret (neqoftese do te emrohen te tille) detyrohen te ruajne karakterin e fshehte te dokumentacionit, informatave, njojurive dhe pervojes se shkembyer ose te realizuar ne kuadrin e shoqerise dhe marrin te gjitha masat per te shmangur perhapjen e tyre qofte edhe pjeserisht.
- Ortaket dhe administratoret pergjigjegjen per pasojet e demshme qe rrjedhin nga shkelja e detyrimeve te mesiperme, neqoftese shkelja ka ndodhur nga nje veprim i qellimshem ose nga pakujdesia

Sa siper vlen edhe per ekspertin kontabel te autorizuar.

Neni 10

Ortaket themelues jane pergjegjes kundrejt te treteve, per pasojet dhe demet qe rrjedhin nga annullimi ose deklarimi i pavlefshem i aktit te themelimit te shoqerise.

Neni 11

Problemet e kapitalit themeltar dhe te pjezeve nominative, transferimi i kapitalit, zmadhimi dhe zvoglimi i kapitalit me ane te kontributeve, menyra e admini-


strimit te shoqerise, emerimi i administratoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar, kompetencat dhe perjegjjsite e tyre, menyra e mbajtjes se llogarive, assembleja dhe keshilli administrativ, falimentimi dhe humbja e 1/2 se kapitalit themeltar, shnderrimi i shoqerise dhe zgjidhja e mosmarrveshjeve si dhe probleme te tjera, percaktohen me me hollesi ne Statutin e shoqerise "FASAL" SHPK.



Statuti i bashkangjitet kesaj kontrate dhe eshte pjese per berese e saj.

O R T A K E T

E

SHOQERISE "FASAL" SHPK


Ardjan Haxhihyseni
not*g*


Albana Dajlani
not*j*

**REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE DURRES
Nr.3033 Rep Nr.1679 Kol.**

V E R T E T I M

Ne Durres sot me dt.30.07.2001, para meje noterit publik Mihal Kazanxhi, u paraqit personalisht Z. Ardjan Haxhihyseni dhe Z. Albana Dajlani me gjeneralitetet e sipershenuara, me zotesi te plete juridike e per te vepruar, identitetet e te cileve i verifikova me pasaportat personale, respektivisht Nr.0950638 dhe Nr.0596894. Te cilet u shprehen seaktin e themelimit e kuptojne dhe e pranojne ate, pasi pasqyron vullnetin e tyre te lire dhe me pas e neneshkruan ate rregullisht ne prezencen time... ...

Per sa me siper une noteri vertetoj.....

N O T E R I

/ MIHAL KAZANXHI /
